



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS
GOVERNMENT OF KOSOVO
VLADA KOSOVA

Numër: 03/238
Datë: 21.02.07

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 shkurt 2007, mori

V E N D I M

1. Miratohet Udhëzimi Administrativ, përbërja dhe kompetencat e komisionit të gjuhëve.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Zyra e Kryeministrit dhe Komisioni i Gjuhëve.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë.

**Kryeministri i Kosovës
Agim ÇEKU**



**INSTITUCIONET E PËRKOSSHME TE VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA**

**ZYRA E KRYEMINISTRIT
URED PREMIJERA
OFFICE OF THE PRIME MINISTER**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV
ADMINISTRATIVNO UPUSTVO
ADMINISTRATIVE INSTRUCTION**

Nr. 03 / 2007

PËRBËRJA DHE KOMPETENCAT E KOMISIONIT TË GJUHËVE

SASTAV I NADLEŽNOSTI KOMISIJE ZA JEZIKE

COMPOSITION AND COMPETENCIES OF THE LANGUAGE COMMISSION

<p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>Ky udhëzim administrativ ka për qëllim që të përcaktojë përbërjen, kompetencat si dhe rregullat e punës të komisionit për gjuhët (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).</p>	<p>Član 1 Cilj</p> <p>Ovo administrativno uputstvo ima za cilj da utvrdi sastav, nadležnosti kao i pravila rada Komisije za jezike (u daljem tekstu: Komisija).</p>	<p>Article 1 The Aim</p> <p>The present Administrative Instruction aims at defining the composition, competencies and rules of procedure of the language committee (hereinafter: the Commission).</p>
<p>Neni 2 Komisioni</p> <p>Komisioni themelohet në bazë të nenit 32.1. të Ligjit Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/51).</p>	<p>Član 2 Komisija</p> <p>Komisija se formira na osnovu člana 32.1. Zakona br. 02/L-37 o upotrebi jezika (Pravilnik UNMIK-a br. 2006/51).</p>	<p>Article 2 The Commission</p> <p>The Commission shall be established on the basis of Article 32.1 of the Law No. 02/L-37 on Use of Languages (UNMIK Regulation N 2006/51).</p>
<p>Neni 3 Kompetencat/përgjegjësitë e Komisionit</p> <p>Komisioni ka këto kompetenca/përgjegjësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. të marrë masa dhe veprime për të siguruar njohjen e statusit të barabartë të gjuhëve zyrtare si dhe për të siguruar mbrojtjen e gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare; ii. të zhvillojë dhe realizojë hetime sipas ankesave që i janë drejtuar apo me iniciativë të vet; iii. të ndërmjetësojë kur kërkohet për të siguruar zbatimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve; iv. të nxjerrë rekomandime mbi korrigjimet dhe përmirësimet e nevojshme; v. të lëshojë vërejtje me shkrim; vi. të hartojë raportin vjetor të Komisionit për Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës; 	<p>Član 3 Nadležnost/odgovornosti Komisije</p> <p>Komisij ima sledeće nadležnosti/odgovornosti:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. preduzimanje mera i aktivnosti radi obezbedjenja priznavanja ravnopravnog statusa službenih jezika kao i obezbedjenja zaštite jezika zajednica , čiji maternji jezik nije službeni jezik; ii sprovođenje i ostvarivanje istrage prema žalbama koje se joj upućuju ili po sopstvenoj inicijativi; iii posredovanje kada se zatraži u cilju obezbedjenja sprovođenja Zakona o upotrebi jezika; iv. donošenje potrebnih ispravki i poboljšanja; v. izdavanje pismenih primedbi; vi. izrada godišnjeg izveštaja Komisije za Vladu i Skupštinu Kosova; 	<p>Article 3 Competencies/Responsibilities of the Commission</p> <p>The Commission shall have the following competencies/responsibilities:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. to undertake measures and actions to ensure the recognition of equal status of official languages as well as to ensure protection communities' languages and mother tongue which are not recognized as official languages; ii. to develop and realize investigations on the basis of complaints addressed or on its own initiative; iii. to mediate when required to ensure the implementation of the Law on Use of Languages; iv. to issue recommendations on necessary revisions and improvements; v. to issue written warnings; vi. to draft the Commission's annual report to

Neni 4
Apelimi/Parashtrimi i Ankesave

- 4.1 Çdo komunitet që konsideron se i është shkelur e drejta për përdorim të gjuhës zyrtare dhe gjuhës në përdorim zyrtar, ka të drejtë që t'i drejtohet komisionit me ankesë, kundër institucionit që konsideron se ka shkelur ligjin.
- 4.2 Ankesa drejtuar komisionit duhet të dorëzohet pranë zyrës së komisionit dhe e njëjta të protokollohet nga asistenti/ja ekzekutive.
- 4.3 Secila ankesë e cila është drejtuar komisionit do të shqyrtohet në afatin kohor prej 15 ditësh dhe brenda këtij afati pala do të merr përgjigje nga komisioni.

Neni 5
Përbërja e Komisionit

- 5.1 Komisioni përbëhet nga këta anëtar:
- i. 1 (një) përfaqësues i Kuvendit të Kosovës;
 - ii. 1 (një) përfaqësues i Zyrës së Kryeministrit;
 - iii. 1 (një) përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë;
 - iv. 1 (një) përfaqësues i Ministrisë së Shërbimeve Publike;
 - v. 1 (një) përfaqësues i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim;
 - vi. 1 (një) përfaqësues i Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - vii. 1 (një) përfaqësues i Ministrisë së

Çlan 4
Apeliranjë/Podnošenje žalbi

- 4.1 Svaka zajednica koja smatra da je prema njoj prekršeno pravo na upotrebu službenog jezika i jezika u službenoj upotrebi, ima pravo da uputi žalbu komisiji, protiv institucije za koju smatra da je prekršila zakon.
- 4.2 Žalba koja se upućuje Komisiji treba da se preda Komisiji i ista da se protokoliše od strane izvršnog asistenta.
- 4.3 Svaka žalba koja se upućuje Komisiji biće razmatrana u roku od 15 dana i u tom roku stranka će dobiti odgovor od Komisije.

Çlan 5
Satava komisije

- 5.1 Komisiju čine sledeći članovi:
- i. 1 (jedan) predstavnik Skupštine Koosva;
 - ii. 1 (jedan) predstavnik Ureda premijera;
 - iii. 1 (jedan) predstavnik Ministarstva pravde;
 - iv. 1 (jedan) predstavnik Ministarstva javnih službi;
 - v. 1 (jedan) predstavnik Ministarstva za zajednice i povratak;
 - vi. 1 (jedan) predstavnik Ministarstva obrazovanja, nauke i tehnologije;
 - vii. 1 (jedan) predstavnik Ministarstva lokalne uprave;

Article 4
Appeal/Submission of Complaints

- 4.1 Any community that considers the violation of their rights for the use of official language is entitled to address complaints to the Commission against the institutions claimed to have violated the law.
- 4.2 Complaints addressed to the Commission shall be submitted at the Office of the Commission and the same shall be recorded by the Executive Assistant.
- 4.3 Any complaint addressed to the Commission shall be reviewed within a period of 15 days, and within this term the party shall receive a reply from the Commission.

Article 5
Commission's Composition

- 5.1 Commission shall comprise the following members:
- i. 1 (one) representative from the Assembly of Kosovo;
 - ii. 1 (one) representative from the Office of the Prime Minister;
 - iii. 1 (one) representative from the Ministry of Justice;
 - iv. 1 (one) representative from the Ministry of Public Services;
 - v. 1 (one) representative from the Ministry of Returns and Communities;
 - vi. 1 (one) representative from the Ministry of Education, Science and Technology;
 - vii. 1 (one) representative from the Ministry

<p>Administrimit të Pushtetit Lokal;</p> <p>5.2 Anëtarët e komisionit duhet të kenë njohuri nga legjislati për gjuhët zyrtare ose nga një lëmi që konsiderohet relevante për punën e Komisionit;</p> <p>5.3 Qeveria emëron anëtarët e propozuar të Komisionit dhe cakton Kryetarin e Komisionit;</p> <p>5.4 Sipas nevojës, me vendimin e Qeverisë, puna e Komisionit mund të ndihmohet nga ekspertë të jashtëm;</p>	<p>5.2 Çlanovi komisione treba da poznaju zakonodavstvo o jezicima ili iz oblasti koja se smatra relevantnom za rad Komisije;</p> <p>5.3 Vlada imenuje predložene članove Komisije i postavlja Predsednika Komisije;</p> <p>5.4 Po potrebi, odlukom vlade, rad Komisije mogu pomagati ispoljni stručnjaci;</p>	<p>of Administration of Local Government</p> <p>Members of the Commission shall have knowledge on the legislation of official languages or an area considered relevant by the Commission;</p> <p>5.3 Government shall appoint the proposed members for the Commission and shall appoint the President of the Commission;</p> <p>5.4 Upon request, and with a decision by the Government, the work of the Commission may be supported by external experts;</p>
<p>Neni 6</p> <p>Kryetari i Komisionit</p> <p>6.1 Kryetari i Komisionit është anëtar i Komisionit dhe emërohet nga Qeveria.</p> <p>6.2 Mandati i Kryetarit të Komisionit zgjat 2 (dy) vjet, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat tjetër.</p> <p>6.3 Kryetari i Komisionit ka këto kompetenca:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. organizon punën e përgjithshme të Komisionit; ii. përgjigjet për veprimtarinë e Komisionit; iii. përfaqëson Komisionin në marrëdhëniet me të tretët, në kontakt me publikun, me organe dhe institucione brenda dhe jashtë vendit; iv. jep autorizim për ushtrimin e detyrave, nënshkruan akte dhe shkresa të tjera; v. në koordinim me anëtarët e Komisionit planifikon programin e punës; vi. koordinon veprimtarinë, përcakton punën dhe detyrat e punës për anëtarët e Komisionit; vii. thërret mbledhjet dhe kujdeset për 	<p>Član 6</p> <p>Predsednik Komisije</p> <p>6.1 Predsednik Komisije je član Komisije i njega imenuje Vlada</p> <p>6.2 Mandat predsednika Komisije traje 2 (dve) godine , uz mogućnost produžavanja na još jedan mandat.</p> <p>6.3 Predsednik Komisije ima sledeće nadležnosti:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. Organizuje opšti rad Komisije; ii. Odgovara za delovanje Komisije; iii. Predstavlja Komisiju u odnosima sa trećim licima, u kontaktu sa javnošću, sa organima i institucijama unutar zemlje i van nje; iv. Daje ovlašćenja za obavljenje zadataka, potpisuje akta i druge spise; v. U koordinaciji sa članovima Komisije planira program rada; vi. Koordiniše delatnost, utrdjuje rad i radne zadatke za članove Komisije; vii. Saziva sastanke i stara se za dobro odvijanje satanka; 	<p>Article 6</p> <p>President of the Commission</p> <p>6.1 President of the Commission shall be member of the Commission appointed by the Government.</p> <p>6.2 The mandate of the President of the Commission shall be for a period of (two) years, with possibilities extension for one more mandate.</p> <p>6.3 President of the Commission shall have the following competencies:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. Organizes the general work of the Commission; ii. Responsible for the activity of the Commission; iii. Represents the Commission on relation with third parties, with the public, both as well as domestic and international institutions; iv. Issues authorization on commission duties, signs acts and other memos; v. In coordination with members of the Commission's plans the work program; vi. Coordinates activities, defines the work and duties for members of the Commission;

<p>mbarëvajtje të mbledhjes;</p> <p>viii. në bazë të projekt raporteve të anëtarëve të Komisionit, përgatit raportin vjetor dhe ia paraqet Komisionit për miratim, para dërgimit në Qeveri dhe Kuvend;</p> <p>ix. informon anëtarët e Komisionit, për punën e vet dhe të Komisionit;</p> <p>x. kryen punë të tjera dhe ndërmerr veprime në interes të Komisionit;</p>	<p>viii. Na osnovu nacрта izveštaja članova Komisije, priprema godišnji izveštaj i podnosi Komisiji na usvajanje, pre dostavljanja Vladi i Skupštini;</p> <p>ix. Informiše članove Komisije o svom radu i o radu Komisije;</p> <p>x. Obavlja i duge poslove i preduzima aktivnosti u ineresu Komisije.</p>	<p>vii. Convenes meetings and ensures that meetings are held properly;</p> <p>viii. On the basis of draft reports on the members of the Commission, prepares the annual reports and submits it to the Commission for approval prior to sending it to the Government and the Assembly;</p> <p>ix. Informs members of the Commission of his work and the work of the Commission;</p> <p>x. Performs other tasks and undertakes actions in the interest of the Commission;</p>
<p>Neni 7</p> <p>Nënkryetari i Komisionit</p> <p>Nënkryetari i Komisionit zgjidhet nga radhët e komuniteteve. Mandati i tij zgjatë 2 (dy) vjet me mundësi vazhdimi edhe për një mandat tjetër.</p>	<p>Član 7</p> <p>Potpredsednik Komisije</p> <p>Podpredsednik Komisije bira se iz redova zajednica.. Njegov mandat traje 2 (dve) godine uz mogućnost produžavanja na još jedan mandat.</p>	<p>Article 7</p> <p>Vice-President of the Commission</p> <p>Vice-President of the Commission shall be appointed from minority communities. His/his mandate shall be 2 (two) years with possibility of extension for one more year.</p>
<p>Neni 8</p> <p>Mandati i Anëtarëve të Komisionit</p> <p>Anëtari i Komisionit emërohet nga Qeveria për një mandat jo më të gjatë se 2 vjet me mundësi vazhdimi edhe për një mandat tjetër.</p>	<p>Član 8</p> <p>Mandat članova Komisije</p> <p>Članove komisije imenuje Vlada na mandat ne dužim od 2 godine uz mogućnost produžavanja na još jedan mandat .</p>	<p>Article 8</p> <p>The Mandate of Members of the Commission</p> <p>Members of the Commission shall be appointed by the Government for a mandate no longer than 2 years, with possibilities of extension for one more mandate.</p>
<p>Neni 9</p> <p>Dorëheqja</p> <p>9.1 Anëtari i Komisionit mund të japë dorëheqje nga pozita e anëtarit të Komisionit duke i dhënë dorëheqje me shkrim Qeverisë.</p> <p>9.2 Kryetari i Komisionit mund të japë dorëheqje nga pozita e Kryetarit duke i dhënë dorëheqje me shkrim Qeverisë.</p>	<p>Član 9</p> <p>Ostavka</p> <p>9.1 Član komisije može dati ostavku sa položaja člana Komisije, podnošenjem pismene ostavke Vladi.</p> <p>9.2 Predsednik Komisije. može dati ostavku sa položaja člana Komisije, podnošenjem pismene ostavke Vladi.</p>	<p>Article 9</p> <p>Resignation</p> <p>9.1 A member of the Commission may resign from his/her post by submitting written resignation to the Government.</p> <p>9.2 The President of the Commission may resign from the post by submitting written resignation to the Government.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 10 Shkarkimi</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Razrëshenje</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Dismissal</p>
<p>10.1 Anëtarët e Komisionit, me vendimin e Qeverisë, mund të shkarkohen përpara përfundimit të mandatit të tyre si anëtarë të Komisionit.</p> <p>10.2 Qeveria mund të shkarkojë anëtarin e Komisionit nëse institucioni i cili përfaqësohet në Komision nga ai anëtar, ka kërkuar nga Qeveria shkarkimin e përfaqësuesit të atij institucioni në Komision dhe emërimin e një përfaqësuesi tjetër.</p> <p>10.3 Komisioni, me shumicë votash, mund të marrë vendim që të kërkojë nga Qeveria të shkarkojë cilindo anëtar të Komisionit duke përfshirë këtu Kryetarin e Komisionit nëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. anëtar i Komisionit nuk i kryen detyrat që i janë dhënë nga Komisioni; ii. nëse ekziston dyshim i bazuar se anëtar i Komisionit ka keqpërdorur privilegjet dhe pozitën e anëtarit të Komisionit në lidhje me marrjen e vendimeve nga sfera e përgjegjësisë së Komisionit; <p>10.4 Kërkesa për shkarkimin e anëtarit të Komisionit, bashkë me procesverbalin e mbledhjes së Komisionit ku është marrë vendim për të kërkuar shkarkimin, brenda 8 ditësh duhet t'i dërgohet për shqyrtim Qeverisë,</p> <p>10.5 Qeveria, përpara se të shkarkojë cilindo anëtar të Komisionit në bazë të paragrafit 10.3 të këtij neni është e obliguar që të marrë pëlqimin e institucionit përfaqësuesi i të cilit është propozuar për shkarkim dhe</p>	<p>10.1 Članovi Komisije mogu, odlukom Vlade, biti razrešeni pre završetka njihovog mandata kao članova Komisije.</p> <p>10.2 Vlada može razrešiti člana Komisije ukoliko institucija koju u toj komisiji predstavljala taj član, zatraži da Vlada razreši predstavnika te institucije u Komisiji i imenuje drugog predstavnika</p> <p>10.3 Komisija, može, većinom glasova, doneti odluku da zatraži od Vlade razrëshenje bilo kog člana Komisije, uključujući i Predsednika Komisije, ako:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. Član Komisije ne izvršava zadatke koje mu je postavila Komisija; ii. Ukoliko postoji osnovana sumnja da je član Komisije zloupotrebjavao privilegije i položaj člana Komisije u vezi donošenja odluka iz delokруга odgovornosti Komisije; <p>10.4 Zahtev za razrëshenje člana Komisije, zajedno sa zapisnikom sastanka Komisije na kojoj je doneta Odluka da se traži razrëshenje, treba, u roku od 8 dana da se dostavi Vladi na razmatranje,</p> <p>10.5 Vlada, pre nego što razreši bilo koji član Komisije na osnovu stava, 10.3 ovog člana obavezna je da pribavi pristanak institucije čiji je predstavnik predložen za razrëshenje i da zatraži od institucije da bez</p>	<p>10.1 A member of the Commission, with the decision of the Government, may be dismissed prior to the termination of his/her mandate as a member of the Commission.</p> <p>10.2 Government may dismiss a member of the Commission if the institution represented by that member asks the Government for the dismissal of his representative and the appointment of another representative.</p> <p>10.3 Commission, with the majority of vote may make a decision asking the Government to dismiss any member of the Commission, including the President of the Commission, if:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. A member of the Commission does not fulfil its duties commissioned by the Commission; ii. There are factual doubts that a member of the Commission has misused his/his privileges and the post as the member of the Commission related to making decisions in the area of Commission responsibilities; <p>10.4 A request to dismiss a member of the Commission, together with the minutes from the meeting of the Commission when the decision was made asking for dismissal, shall be sent to the Government within 8 days.</p> <p>10.5 The Government, prior to dismissing a member of the Commission, on the basis of paragraph 10.3 of this Article, is obliged to get the approval of the representative institution whose representative</p>

të kërkojë nga institucioni që pa vonesë të propozojë përfaqësuesin e institucionit që do të zëvendësojë anëtarin e shkarkuar të Komisionit.

10.6 Anëtarët e Komisionit janë të obliguar për pjesëmarrje në të gjitha takimet e Komisionit. Mospjesëmarrja pa arsye dhe paralajmërim në tri takime mund të sjellë në përjashtimin/largimin e anëtarit nga Komisioni.

Neni 11

Koha dhe Vendi i Takimeve

11.1 Takimet e Komisionit do të mbahen në kohën dhe vendin ku vendos Kryetari i Komisionit ose Komisioni.

11.2 Kryetari i Komisionit:

(a) mund ta thërrasë takimin në çdo kohë, me paralajmërim 3 (tre) ditë më parë përveç në raste të jashtëzakonshme,

(b) është i obliguar ta thërrasë takimin nëse kjo kërkohet nga 3 (tre) anëtarë të Komisionit.

Neni 12

Mbledhja e Komisionit

12.1 Mbledhjen e Komisionit e udhëheq:

(a) Kryetari i Komisionit,

(b) nëse Kryetari nuk është prezent, nënkryetari i komisionit.

12.2 Marrja e vendimeve:

(a) kuorumi përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë;

(b) çështja vendoset nga shumica e votave të anëtarëve prezent në votim;

(c) secili anëtar prezent ka një votë në secilin

odlloganjanja predlozi predstavnik institucije koji će zameniti razrešenog člana Komisije.

10.6 Članovi komisiju su dužni da učestvuju na svim sastancima Komisije. Neopravdano i nenajavljeno neučešće na tri sastanka može dovesti do isključenja/udaljavanja člana Komisije.

Član 11

Vreme i mesto sastanaka

11.1 Sastanci komisije održaće se u vremenu i mestu o kome odlučuje Predsednik Komisije ili Komisija

11.2 Predsednik Komisije:

(a) može sazvati sastanak u svako vreme uz prethodnu najavu od 3 (tri) dana ranije, osim u vanrednim slučajevima,

(b) je dužan da sazove sastanak ako to traže 3 (tri) člana Komisije.

Član 12

Sastana Komisije

12.1 Sastankom Komisije rukovodi:

(a) Predsednik Komisije,

(b) podpredsednik Komisije, kada je predsednik odsutan.

12.2 Donošenje odluka:

(a) kvorum čine 5 (pet) članova;

(b) o pitanjima se odlučuje većinom glasova prisutnih članova pri glasanju;

(c) svaki prisutan član ima jedan glas o

proposed for dismissal and to ask from the institution to propose, without delay another representative to replace the dismissed member of the Commission.

10.6 Members of the Commission are obliged to participate at all meetings of the Commission. Unjustified absence without a prior notice in three meetings may result in dismissal from the Commission.

Article 11

Time and Location of Meetings

11.1 Commission meetings shall be held at the time and location as decided by the President of the Commission or the Commission.

11.2 The President of the Commission:

(a) may convene a meeting at any time, with (three) days notice, apart from extraordinary cases;

(b) is obliged to convene a meeting if that required by 3 (three) members of the Commission.

Article 12

Commission Meetings

12.1 The meetings of the Commission shall be chaired by:

(a) The President of the Commission;

(b) The Vice-President, in absence of the President;

12.2 Decision-making:

(a) the quorum comprises 5 (five) members

(b) a decision is made by the majority vote of the present members;

(c) each member present shall be entitled to

<p>çështje për të cilën merret vendim, dhe nëse votat janë të barabarta, vota e Kryetarit të Komisionit vendos.</p> <p>12.3 Komisioni mban takime sipas nevojës.</p> <p>12.4 Gjatë mbledhjes mbahet procesverbal</p>	<p>svakom pitanju o kojoj se odlučuje, a ako su glasovi izjednačeni, odlučuje glas predsjednika Komisije.</p> <p>12.3 Komisija održava satanke prema potrebi;</p> <p>12.4 Na sastanku vodi se zapisnik</p>	<p>single vote on each issue being decided and if there is a situation of equal number of votes; the vote of the President of the Commission shall be the casting vote.</p> <p>12.3 The Commission shall assemble when needed.</p> <p>12.4 Minutes shall be held during meetings.</p>
<p>Neni 13</p> <p>Personeli ndihmës i komisionit</p> <p>13.1 Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të tij, Komisionit i sigurohet një personel ndihmës-Asistent / ekzekutiv Komisionit (në tekstin e mëtejshëm: Asistenti).</p> <p>13.2 Asistenti i Komisionit është nëpunës civil.</p>	<p>Član 13</p> <p>Pomočno osoblje Komisije</p> <p>13.1 U ciju vršenja njegovih funkcija, Komisiji se obezbeđuje pomočno osoblje-Izvršni asistent Komisije t (u daljem tekstu: Asistent).</p> <p>13.2 Asistent Komisije je civilni službenik.</p>	<p>Article 13</p> <p>Commission's Support Staff</p> <p>13.1 With the purpose of exercising its activity the Commission shall be entitled to support staff/Executive Assistant to the Commission (hereinafter: Assistant).</p> <p>13.2 Commission's Assistant shall be a civil servant.</p>
<p>Neni 14</p> <p>Përgjegjësitë e Asistentit</p> <p>14.1 Asistenti është personel ndihmës i Komisionit dhe kryen detyra të karakterit administrativ, informativ, teknik me qëllim që të sigurojë Komisionin me çdo asistencë, gjithashtu edhe me të gjitha dokumentet gjegjëse, të nevojshme për Komisionin, në mënyrë që ai të zbatojë përgjegjësitë e veta.</p> <p>14.2 Asistenti i komisionit ofron përkrahjen logjistike të nevojshme dhe do të shërbejë si pikë kontakti kryesore për të gjithë anëtarët e Komisionit për çështjet lidhur me komunikimin, përfshirë këtu përgatitjen dhe shpërndarjen e rendeve të ditës dhe procesverbaleve nga mbledhjet, mbajtjen e dosjeve elektronike dhe në letër për Komisionin si dhe sigurimin e sallave të takimeve.</p>	<p>Član 14</p> <p>Odgovornost asistenta</p> <p>14.1 Asistent je pomočno osoblje Komisije i obavlja zadatke od administrativnog-informativnog i tehničkog karaktera sa ciljem da obezbedi Komisiji svaku pomoć a isto tako i svu odgovarajuću dokumentaciju, potrebne Komisiji da bi ona sprovedila njene odgovornosti.</p> <p>14.2 Asistent Komisije pruža potrebnu logističku podršku i služiće kao glavna kontaktna tačka za sve članove Komisije o pitanjima u vezi sa komuniciranjem, uključujući i pripremanje i dostavljanje dnevnog reda i zapisnika sa sastanaka, vođenje elektronskih i pisanih dosijea za Komisiju kao i obezbeđenje sale za sastanke.</p>	<p>Article 14</p> <p>Assistant's Responsibilities</p> <p>14.1 The Assistant shall act as the personal assistant to the Commission and shall perform other duties of administrative information and technical nature aiming at ensuring all kind of support to the Commission as well as with all respective documents necessary for the Commission in order to implement its responsibilities.</p> <p>14.2 Commission's Assistant shall provide necessary logistic support and shall serve as the main contact point for all members of the Commission with regards to communication issues, including preparation and distribution of agenda and minutes from the meetings, filing of electronic and hard copy files as well as to ensure meeting rooms.</p>

Neni 15

- 15.1 Për punën e anëtarëve të Komisionit do të vendosë Qeveria e Kosovës në harmoni me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës.
- 15.2 Zyra e Kryeministrit i ofron përkrahjen logjistike Komisionit për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi sipas këtij udhëzimi administrativ dhe ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Neni 16


Marrja e masave të tjera nga Komisioni do të bëhet në pajtim me udhëzimin administrativ për sanksionet administrative të lëshuar nga Ministria e Shërbimeve Publike.

Neni 17

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi pas aprovimit nga Qeveria e Kosovës dhe në ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

Prishtinë 29.02.2007

Kryeministri i Kosovës
Agim Çeku



Član 15

- 15.1 O radu članova Komisije odlučice Vlada Kosova u skladu sa Konsolidovanim Budžetom Kosova .
- 15.2 Ured Premijera pruža logističku podršku Komisiji za izvršavanje zadataka i odgovornosti prema ovom administrativnom uputstvu i Zakonu o upotrebi jezika.

Član 16

Preduzimanje ostalih mera od strane Komisije obaviće se u skladu sa administrativnim uputstvom o administrativnim sankcijama koje je izdalo Ministarstvo javnih službi.

Član 17

Ovo administrativno uputstvo stupiće na snagu nakon usvajanja od strana Vlade Kosova i na dan potpisivanja od strane Premijera.

Prishtina _____

Premijer Kosova
Agim Çeku

Article 15

- 15.1 Government of Kosovo shall decide on the work of Commission's members in compliance with the Kosovo Consolidate Budget.
- 15.2 Office of the Prime Minister shall provide logistical support to the Commission on accomplishment of duties and responsibilities on the basis of the present administrative instruction and the law on the use of languages.

Article 16

Other measures to be undertaken by the Commission shall be in compliance with the administrative instruction on administrative sanctions issued by Ministry of Public Services.

Article 17

The present administrative instruction shall enter into force after the approval by the Government of Kosovo and on the day of signature by the Prime Minister.

Prishtina _____

Prime Minister of Kosovo
Agim Çeku



INSTITUCIONET E PËRKOSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

ZYRA E KRYEMINISTRIT
URED PREMJERA
OFFICE OF THE PRIME MINISTER

SEKRETARI I PËRHERSHËM
STALNI SEKRETAR
PERMANENT SECRETARY

Dt, 16/02/2007
Br. _____

CERTIFIKAT O PROCEDURALNOJ USAGLAŠENOSTI ADMINISTRATIVNOG
UPUTŠTVA Br. xx/2007
SASTAV I NADLEŽNOSTI KOMISIJE ZA JEZIKE

Na osnovu člana 24. stav 24.2(a) o "Posebnim pravilima o obliku i sadržaju nacrta zakon i drugih zakonskih/podzakonskih akata" i člana 29, stav 29(9) Pravilnika o radu Vlade o "Posebnim procedurama pripreme nacrta zakona i drugih zakonskih i podzakonskih akata," izjavljujem da Administrativno Uputstvo br. XX/2007, Sastav i nadležnosti Komisije za jezike: prošao kroz sve faze postupka predviđene Pravilnikom o radu Vlade.

Fitim Krasniqi,
Stalni sekretar UP-a



INSTITUCIONET E PËRKOSHME TË VETËQEVERISJES
 PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA
 PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

ZYRA E KRYEMINISTRIT
 URËD PREMJERA
 OFFICE OF THE PRIME MINISTER

SEKRETARI I PËRHERSHËM
 STALNI SEKRETAR
 PERMANENT SECRETARY

Dt. 16/02 /2006
 Nr. _____

**CERTIFICATION ON PROCEDURAL COMPLIANCE ADMINISTRATIVE
 INSTRUCTION No. xx/2007 on Composition and Competencies of the
 Language Commission**

For implementation of article 24, paragraph 24.2 (a) on "Special Rules Governing the Form and Substance of Draft Laws and other Draft Normative/Sub normative Legal Acts", and article 29, paragraph 29 (9) of the Rule of Procedure of Government on "Special Procedures Governing the Preparation of Draft Laws and other Draft Normative/Sub-Normative Legal Acts", I declare that Administrative Instruction No. xx/2007 on Composition and Competencies of the Language Commission has been proceeded under all procedural stages envisaged by the Rule of Procedure of the Government.

Fitim Krasniqi,
 Permanent Secretary OPM

Të marrë masa dhe veprime për të siguruar njohjen e statusit të barabartë të gjuhëve zyrtare si dhe për të siguruar mbrojtjen e gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, të zhvillojë dhe realizojë hetime sipas ankësive që i janë drejtuar apo me iniciativë të vet, të ndërmjetësojë kur kërkohet për të siguruar zbatimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve, të nxjerrë rekomandime

5. Çështjet e adresuara nga udhëzimi

Mungesa e dispozitave në Ligjin për Gjuhët që do të rregullonin pjesëmarrjen e institucioneve në komisionin për gjuhët, mandatin dhe punën e komisionit, si dhe mundësia për parashtrimin e ankësive.

4. Arsyetimi për udhëzimin

Komisioni themelohet në bazë të nenit 32.1. të Ligjit Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/51).

3. Nevoja për udhëzimin

Ky udhëzim administrativ ka për qëllim që të përcaktojë përberjen, kompetencat si dhe rregullat e punës të komisionit për gjuhët.

2. Fusha e veprimit të udhëzimit:

PËRBËRJA DHE KOMPETENCAT E KOMISIONIT TË GJUHËVE

1. Titulli i udhëzimit:

MEMORANDUMI SHPJEGUES

INSTITUCIONET E PËRKOSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENË INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
QEVERIA E KOSOVËS
VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



mbi korrigjimet dhe përmirësimet e nevojshme, të lëshojë vërejtje me shkrim, të hartojë raportin vjetor të Komisionit për Qeverinë dhe Kuendin e Kosovës.

6. Qëllimi i udhëzimit

Përcaktimi i dispozitave për funksionimin dhe zbatimin e Ligjit për Gjyhet.

7. Përmbajtja e udhëzimit

Ky udhëzim përbehet prej 17 neneve ku janë sqaruar në mënyrë të qartë dispozitatat për funksionimin përberjen, kompetencat si dhe rregullat e punës të komisionit për gjyhet.

8. Rëndësia e udhëzimit

Është shumë e madhe për arsye se synohet përcaktimi i dispozitave për funksionimit e komisionit për gjyhet si dhe përmbylljen e një procesi të rëndësishëm në lidhje me standardin I-rë, pika 7.2

9. Hartimi i udhëzimit në përputhje me nenin 4. 3 të Rregullores së Punës e Qeveris së Kosovës

Islam Caka
Zyrtar i lartë ligjor i ZSHNJ-së

Da preduzima mere i delovanja kako bi se obezbedilo priznavanje ravnopravnog statusa službenih jezika kao i da bi se obezbedila zaštita jezika zajednica, čiji maternji jezik nije službeni jezik, da razvija i realizuje istrage na osnovu žalbi koje su im upućene, ili po potrebi jezika, da donosi preporuke o potrebnom korigovanju i ispravkama, da upućuje pismene primedbe, da izradi godišnji izveštaj Komisije za Vladu i Skupštinu Kosova.

5. Adresirana pitanja iz uputstva

Nedostatak odredbi u Zakonu o jezicima koji bi regulisali učesće institucija u komisiji za jezike, mandat i rad komisije, kao i mogućnost podnošenja žalbi.

4. Obrazloženje uputstva

Komisija se osniva na osnovu člana 32.1 Zakona br.02/L-37 o upotrebi jezika (Pravilnik UNMIK-a br.2006/51).

3. Potreba za uputstvom

Administrativno uputstvo ima za cilj da utvrdi sastav, nadležnosti kao i pravila rada komisije za jezike.

2. Delokrug uputstva:

SASTAV I NADLEŽNOSTI KOMISIJE ZA JEZIKE

1. Naziv uputstva:

MEMORANDUM SA OBJAŠNJENJIMA

INSTITUCIONET E PËRKOSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
GEVERIA E KOSOVES
GOVERNMENT OF KOSOVO
VLADA KOSOVA



6. Cilj uputstva

Utvrdivanje odredbi o funkcionisanju i primeni Zakona o jezicima.

7. sadržaj upustva

Uputstvo se sastoji od 17 članova, u kojima su jasno objašnjene odredbe o funkcionisanju, sastav, nadležnosti kao i pravila rada komisije o jeziku.

8. Značaj uputstva

Je veoma veliki, jer se stremi ka utvrđivanju odredbi o funkcionisanju komisije o jeziku kao i ka zaključivanju jednog značajnog procesa u vezi sa I –im standardom, tačka 7.2

9. Izrada uputstva u skladu sa članom 4.3 Pravilnika o radu Vlade Kosova

Islam Caka

Visoki zakonodavni zvaničnik KUPP



INSTITUCIONET E PËRKOSHME TE VETËQEVERISJES
 PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVE
 PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
 ZYRA E KRYEMINISTRIT
 URED PREMJERA
 OFFICE OF THE PRIME MINISTER

Për: Z. Agim Çeku,
 Kryeministër i Kosovës

Përmes: Fitim Krasniqi
 Sekretar i Përhershëm

Cc: Shefik Kurteshi,
 Drejtor i ZSHNJ-së

Nga: Islam Caka
 Zyrtar i lartë i lartë i lartë

Lënda: Ekspozë për Udhëzimin Administrativ Përbërja dhe Kompetencat e Komisionit të Gjyhëve

Date: 19. 02. 2007

Numer: 1560/2007

Udhëzimi administrativ Përbërja dhe Kompetencat e Komisionit të Gjyhëve
 Të nderuar ministra, zonja dhe zotërinj

- Para jush e paraqes për aprovim udhëzimin administrativ Përbërja dhe Kompetencat e Komisionit të Gjyhëve, iniciativë e Zyres së Kryeministrit.
- Ky Udhëzimi përcakton rregullat praktike për zbatimin e Ligjit Nr. 02/L-37 Për Përdorimin e Gjyhëve i miratuar nga kuvendi i Kosovës dhe i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/51.
- Ky udhëzim përbehet prej 17 neneve ku janë sqaruar në mënyrë të qartë dispozitat për funksionimin përberjen, kompetencat si dhe rregullat e punës të komisionit për gjyhët.

• Rëndësia e udhëzimit administrativ është shumë e madhe për arsye se synohet përcaktimi i dispozitave për funksionimin e komisionit për gjyhët si dhe përmbylljen e një procesi të rëndësishëm në lidhje me standardin I –rë, pika 7.2

Me respekt

